



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:126958

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05783730

KPPP.nr. 748/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “King Security” Sh.P.K., me seli në Prishtinë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Murat Paçarada, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 175/24, të lejuar me datë 26.03.2024, nga Përbaruesi Privat Fadil Hoxha me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 05.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “King Security” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 175/24, të lejuar me datë 26.03.2024, nga Përbaruesi Privat Fadil Hoxha, ANULOHET.
- II. DETYROHET kreditori që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej EUR 270.00 (dyqind e shtatëdhjetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, mbi bazën e dokumentit përbarimor, Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr. 2519/19, të datës 01.03.2022, ka lejuar Urdhrit Përbarimor P.nr. 175/24, të datës 26.03.2024, me të cilin është detyruar debitorit “King Security” Sh.P.K., që kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 3,300.00 si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin mbi lejimin e përmbartimit, me arsyetim se titulli ekzekutiv – aktgjykimi mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbartimore nuk është i formës së prerë dhe se i njëjti është prishur me datë 30.06.2022 kur gjykata ka lejuar kthimin në gjendje të mëparshme me aktvendimin A.nr. 2159/19, të datës 01.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Andaj, ka shtuar se organi përmbartues nuk ka mundur të lejoj urdhrin mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i formës së prerë. Në fund, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet si dhe të obligohet kreditori që debitorit t’ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimin në lartësi prej EUR 270.00.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit, për arsyet si në vijim:

Me nenin 21 të LPP-së, është përcaktuar se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa, sipas nenit 24.1 të LPP-së, *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbartueshem po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*. Në anën tjetër me nenin 27.1 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative elementet të cilat duhet ti përmbaj dokumenti përmbartimor për të shërbyer si dokument i përshtatshëm për përmbartim, ku sipas kësaj dispozite *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimi”*.

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cituara si më lartë dhe bazuar në shkresa të lëndës, gjen se Aktgjykimi A.nr. 2519-19, i datës 01.03.2022, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 1 dhe nenin 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk është përmban klauzolën e

plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Poashtu, gjykata vlerëson se aktgjykimi në fjalë nuk i plotëson as kushtet e përcaktuara në nenin 27.1 të LPP-së me të cilin parashihet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që me të njëjtin aktgjykim është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “King Security” këtu debitorit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 793/2019 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo nuk është detyruar debitori në përmbushje të detyrimit të kërkuar si në propozim për përmbarim nga ana e kreditorit.

Veç të gjeturave si më lartë, bazuar në shkresat e lëndës aktgjykimi objekt përmbarimi në këtë procedurë rezulton të jetë prishur me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 2519/19, të datës 30.06.2022, me rastin e vendosjes sipas kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme dhe si rrjedhojë prapësimi i debitorit gjen mbështetje edhe në nenin 71, pika 1.2 të LPP-së, me të cilin parashihet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*.

Gjykata, gjatë vendosjes në këtë çështje përmbarimore pati parasysh edhe vendimet e nxjerra në procedurë nga organi administrativ, këtu kreditori, të cilat i janë bashkangjitur në kopje propozimit për përmbarim si provë, mirëpo në rastin konkret rezulton se kreditori propozimin për përmbarim e ka mbështetur në Aktgjykimin A.nr. 2519/19, të datës 01.03.2022 mbi bazën e të cilit është lejuar edhe urdhri përmbarimor nga ana e përmbaruesit privat, andaj gjykata nuk u lëshuar në vlerësimin e elementeve të përmbarueshmërisë të këtyre vendimeve të nxjerra në procedurë administrative.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet debitorit në emër

të prapësimit të ushtruar përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 270.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 71 paragrafi, 1, pika 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 748/24, datë 05.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.